25
02.03.2016

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 02.03.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 21, të datës 02.02.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), Nenin 27, shkronja (c dhe ç) dhe Nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2014 dhe 2015, në vitin fiskal 2016 në shumë të përgjithshme prej 1,096,257.27€, nga fondi burimor 21, 22 dhe 31.

2. Ridestinimi i të hyrave vetjake nga fondi burimor 21, për bartje është në shumë totale prej 978,662.73€, fondi burimor 22 është 66,756.54€ dhe fondi burimor 31 është 50,838.00€, të shpërndara nëpër kodet e programeve e nënprogrameve, kodet e projekteve kapitale nëpër kategoritë ekonomike buxhetore si vijon:

| Fond Buri | Org Buxh | Kodi i Prog | Programi | Kat Eko | Përshkrimi i Kat.Eko.Proj | Kodi i Proj | Shuma e Zotimeve (Obligi--met) Mjetet e lira për bartje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 612 | 16002 | Zyra e Kryetarit të Komunës | 130 | Mallra e e shërbime | | 5,000.00€ |
| 21 | 612 | 16002 | Zyra e Kryetarit të Komunës | 200 | Subvencione e transfere | | 10,000.00€ |
| 21 | 612 | 16302 | Administrata Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 5,000.00€ |
| 21 | 612 | 16603 | Inspektorati Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 5,000.00€ |
| 21 | 612 | 16902 | Zyra e Kuvend-it të Komunës | 130 | Mallra e shërbime | | 5,000.00€ |
| 21 | 612 | 17502 | Buxhet | 130 | Mallra e shërbime | | 5,000.00€ |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Bashkëfinanc-imi i projekteve | 40081 | 20,073.40€ |
| 21 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Blerja e automjeteve | 40084 | 16,453.73€ |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 130 | Mallra e shërbime | | 55,000.00€ |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Mirëmbajtja - e Infrastrukturës rrugore | 40087 | 9,945.10€ |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Ndërtimi i - rrethojave të varrezave në Fushë-Kosovë | 40088 | 31,122.50€ |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Blerja e - kontejnerëve | 40089 | 15.96€ |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Pastrimi i - ambientit | 40090 | 19,404.96€ |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Ndërtimi i - parqeve, trotuareve dhe shëtitoreve | 40091 | 36,559.58€ |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Rastet emër - gjente | 40092 | 6.20€ |
| 21 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Mirëmbajtja - e ndriçimit | 40094 | 1,640.01€ |
| 21 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Rregullimi - i ujit në fshatin Harilaç | 40099 | 35,000.00€ |
| 21 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Mbikalimi - në fshatin Miradi e Poshtme | 40100 | 40,000.00€ |
| 21 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Sinjalizimi - horizontal dhe vertikal i rrugëve | 40101 | 30,235.06€ |
| 21 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Ngjyrosja e - Kompleksit banesor në Fushë-Kosovë | 40102 | 45,000.00€ |
| 21 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Shtrurja e - rrugëve terciare me zhavorr | 40104 | 219.50€ |
| 21 | 612 | 47042 | ZH.R.INS-Bujqësisë Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 5,000.00€ |
| 21 | 612 | 47042 | ZH.R.INS-Bujqësisë Fushë-Kosovë | 300 | Pyllëzimi i - sipërfaqeve të zhveshura | 40105 | 10,000.00€ |
| 21 | 612 | 47042 | ZH.R.INS-Bujqësisë Fushë-Kosovë | 300 | Pastrimi - sanitar i pyjeve | 40106 | 90.00€ |
| 21 | 612 | 47042 | ZH.R.INS-Bujqësisë Fushë-Kosovë | 300 | Kastrimi i - qenve endacakë | 40107 | 19.40€ |
| 21 | 612 | 47042 | ZH.R.INS-Bujqësisë Fushë-Kosovë | 300 | Dezinfektimi - dezinsktimi dhe derratizimi | 40108 | 192.18€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 5,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- | 300 | Asfaltimi - | 40109 | 331.00€ |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | RREG Fushë-Kosovë | | në Fushë-Kosovë | | |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Graboc i Poshtëm | 40110 | 20,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Bardh i Vogël | 40112 | 10,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Vragoli | 40114 | 20,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Miradi e Epërme | 40115 | 25,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në Nakarad | 40116 | 10,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Harilaç | 40117 | 20,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Henc | 40118 | 20,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Lismir | 40119 | 6,100.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - i rrugës Miradi e Poshtme/Miradi e Epërme | 40120 | 10,078.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Bardh i Madh | 40121 | 4,007.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Miradi e Poshtme | 40122 | 25,000.00€ |
| 21 | 612 | 66015 | PL.HAPS- RREG Fushë-Kosovë | 300 | Ndërrimi i - rrjeteve të kanalizimeve dhe ujësjellësve | 40123 | 70,000.00€ |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 20,000.00€ |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 200 | Subvencione e transfere | | 10,000.00€ |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 300 | Blerja e - pajisjeve për shëndetësi | 40124 | 4,673.00€ |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 300 | Ndërtimi i - shtëpive për rastet sociale | 40126 | 2,508.70€ |
| 21 | 612 | 75506 | Shërbimet - sociale Fushë-Kosovë | 300 | Rregullimi - i oborrit dhe mirëmbajtja e objektit të QPS-së | 40128 | 8.45€ |
| 21 | 612 | 85002 | Shërbimet - kulturore Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 5,000.00€ |
| 21 | 612 | 85002 | Shërbimet - kulturore Fushë-Kosovë | 200 | Subvencione e transfere | | 10,000.00€ |
| 21 | 612 | 85002 | Shërbimet - kulturore Fushë-Kosovë | 300 | Renovimi i - Qendrës së Kulturës | 40129 | 30,000.00€ |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 612 | 85002 | Shërbimet - kulturore Fushë-Kosovë | 300 | Mirëmbajtja - e fushave dhe sallave të sportit | 40131 | 80,000.00€ |
| 21 | 612 | 85002 | Shërbimet - kulturore Fushë-Kosovë | 300 | Botimi - i librave, revistave, fletushkave e tjera | 40133 | 20,000.00€ |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 20,000.00€ |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 200 | Subvencione e transfereve | | 10,000.00€ |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 300 | Ndërtimi i shkollës në fshatin Vragoli | 40137 | 125,756.00€ |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 300 | Blerja - e inventarit | 40139 | 4,223.00€ |
| 22 | 612 | 16002 | Zyra e Kryetarit të Komunës | 130 | Mallra e e shërbime | | 0.79€ |
| 22 | 612 | 16002 | Zyra e Kryetarit të Komunës | 200 | Subvencione e transfere | | 0.72€ |
| 22 | 612 | 16302 | Administrata Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 0.10€ |
| 22 | 612 | 16603 | Inspektorati Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 0.24€ |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 130 | Mallra e shërbime | | 3.79€ |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 200 | Subvencione e transfere | | 21.32€ |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Blerja e mobileve | 87145 | 21.14€ |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Bashkëfinc- imi i projekteve | 89168 | 1.00€ |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Blerja e apar- tit fotokopjues dhe pajisjeve tjera | 89173 | 190.00€ |
| 22 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 130 | Mallra e shërbime | | 47.38€ |
| 22 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Mirëmbajtja e - infrastrukturës rrugore, kanalizimeve dhe ujësjellësve | 89174 | 925.96€ |
| 22 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Blerja e - kontejnerëve | 89175 | 11.46€ |
| 22 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Ndërtimi i - parqeve, trotuareve horizontale | 89177 | 336.58€ |
| 22 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Rastet emër - gjente | 89178 | 20.00€ |
| 22 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Vendosja e - ndriçimit publik | 89179 | 44,010.00€ |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Mirëmbajtja - e ndriçimit | 89181 | 557.10€ |
| 22 | 612 | 18161 | Inf. Publike | 300 | Shtrurja e - rrugëve terciare me zhavorr | 89188 | 512.35€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 3.23€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Pastrimi i - lumit Drenica dhe hapja e kanalit në Bardh të Vogël | 85111 | 44.58€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Sllatinë e Madhe | 89197 | 3.00€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Vragoli | 89198 | 149.50€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Miradi e Epërme | 89199 | 1,415.00€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në Nakarad | 89200 | 330.00€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Harilaç | 89201 | 7,235.00€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Asfaltimi - në fshatin Miradi e Poshtme | 89204 | 8,310.00€ |
| 22 | 612 | 66015 | PL.HAPS-RREG Fushë-Kosovë | 300 | Ndërtimi i - rrjeteve të kanalizimeve dhe ujësjellësve | 89206 | 974.96€ |
| 22 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 6.18€ |
| 22 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 200 | Subvencione e transfere | | 45.00€ |
| 22 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 300 | Rregullimi - i oborreve të ambulantave | 87179 | 12.44€ |
| 22 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë Fushë-Kosovë | 300 | Ndërtimi i - shtëpive për rastet sociale | 89210 | 12.00€ |
| 22 | 612 | 85002 | Shërbimet - kulturore Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 2.21€ |
| 22 | 612 | 85002 | Shërbimet - kulturore Fushë-Kosovë | 200 | Subvencione e transfere | | 0.46€ |
| 22 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 130 | Mallra e shërbime | | 0.06€ |
| 22 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 200 | Subvencione e transfereve | | 6.00€ |
| 22 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 300 | Rrethoja - e shkollës në fshatin Bardh i Vogël | 84020 | 1,516.99€ |
| 22 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit Fushë-Kosovë | 300 | Blerja - e inventarit | 89220 | 30.00€ |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 31 | 612 | 47042 ZH.R.INS- 200 Bujqësisë Fushë-Kosovë | Blerja e - serrave | 72371 | 16,800.00€ |
| 31 | 612 | 47042 ZH.R.INS- 200 Bujqësisë Fushë-Kosovë | Blerja e - makinave mjelëse | 72381 | 1,914.00€ |
| 31 | 612 | 47042 ZH.R.INS- 200 Bujqësisë Fushë-Kosovë | Blerja e - pompave spërkastëse | 72386 | 2,751.00€ |
| 31 | 612 | 47042 ZH.R.INS- 200 Bujqësisë Fushë-Kosovë | Blerja e - pulave | 72412 | 4,995.20€ |
| 31 | 612 | 47042 ZH.R.INS- 200 Bujqësisë Fushë-Kosovë | Blerja e - gjedhave - lopëve qumështore | 72415 | 20,525.40€ |
| 31 | 612 | 47042 ZH.R.INS- 200 Bujqësisë Fushë-Kosovë | Blerja e - mekanizmit bujqësorë. | 72417 | 3,852.40€ |

Totali i buxhetit për bartje nga fondet burimor 21, 22 dhe 31 nga viti 2014 dhe 2015, në vitin 2016 është në shumë prej: 1,096,257.27€.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.**

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA * KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS * OPŠTINA KOSOVO POLJE * KUVENDI I KOMUNËS * SKUPŠTINA OPŠTINA * FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

26
07.03.2016

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 07.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 19, të datës 16.02.2016, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, në lidhje me kërkesën Nr. 05-350-779 të datës 12.01.2016, të paraqitur nga pala Ruzhdi Thaçi, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Aprovohet propozimi Nr. 19 i datës 16.02.2016, për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit të objekteve (afarist P+1 dhe depo P+0), në ngastrën kadastrale P-72514003-00779-6, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5524m² në zonën kadastrale Harilaç, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 05-095-30078, pronë në qirambajtje për 99 vite, nga pala Ruzhdi Thaçi me destinim për:

1.1 Objekt për riciklim të plastikës me etazhitet P+0, në sipërfaqe S=351.88m²;
1.2 Objekt afarist me etazhitet P+1, përdhesë në sipërfaqe S=88.40m² dhe kati i parë në sipërfaqe S=93.51m².

2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Inspektoratit, pas marrjes së dokumentacionit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

3. Ky vendim hyn në fuqi, ditë e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së Inspektoratit, Palës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

27
07.03.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 07.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 05, të datës 22.01.2016, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 22, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare 18/2012), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Aprovohet për diskutim publik, propozimi për caktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore, në shumë prej 2.40€ për metër katror.

2. Kryerja e procedurave për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.

3. Ky vendim hyn në fuqi, ditë e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

28
07.03.2016

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 07.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 113, të datës 10.02.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 113 të datës 10.02.2016, për riprogramimin e borxhit nga banesat e shitura në 'Kompleksin 300', në Fushë-Kosovë, për periudhën 240 muaj (20 vjet), për punëtorët e Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës.

2. Riprogramimi i borxhit të mbetur i llogaritur sipas shkresës, së datës 10.02.2016 në shumë të përgjithshme prej 102,601.89€, ndalet nga xhirollogaritë e të ardhurave personale në baza mujore për punëtorët e komunës si vijon:

2.1 Violeta Xhigoli - Konjuhi, për borxhin në shumë prej 5,888.99€, i ndalet kësti mujor prej 24.54€;
2.2 Rrustem Shala, për borxhin në shumë prej 3,886.77€, i ndalet kësti mujor prej 16.20€;
2.3 Abdullah Tërnava, për borxhin në shumë prej 9,329.00€, i ndalet kësti mujor 38.87€;
2.4 Besim Tërmkolli, për borxhin në shumë prej 20,500.00€, i ndalet kësti mujor prej 85.42€;
2.5 Vlora Berjani, për borxhin në shumë prej 2,668.64€, i ndalet kësti mujor prej 11.12€;
2.6 Jusuf Maxhera, për borxhin në shumë prej 7,219.00€, i ndalet kësti mujor prej 30.08€;
2.7 Ali Topalli, për borxhin në shumë prej 18,500.00€, i ndalet kësti mujor prej 77.08€;
2.8 Fadil Konjusha, për borxhin në shumë prej 11,103.72€, i ndalet kështi mujor prej 46.27€;
2.9 Xhezair Krasniqi, për borxhin në shumë prej 10,545.77, i ndalet kësti mujor prej 43.94€;
2.10 Enver Ademi, për borxhin në shumë prej 12,960.00€, i ndalet kësti mujor prej 54.00€.

3. Tjetërsimi (shitja) dhe bartja e të drejtës formalo-juridike të pronave - banesave të evidentuara në vendimin e Kuvendit të Komunës, Nr. 102, të datës 01.09.2010, në 'Kompleksin 300', në Fushë-Kosovë, te personat e tretë, nuk mund të bëhet pa kryer borxhin e mbetur, (kryerjen e obligimeve financiare të borxhit ndaj komunës), nga punëtorët e komunës të cekur në pikën 2 të vendimit.

4. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës.

5. Ky vendim hyn në fuqi, ditë e aprovimit, nga Kuvend i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së GJKP, Punëtorëve të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

29
07.03.2016

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 07.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 111, të datës 10.02.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave e Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

## V E N D I M

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 165€, për mbulimin e shpenzimeve për çdo ceremoni të varrimit për qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.

2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për vitin 2016, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit.

3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë për Shërbime Publike e Mjedis.

4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës dhe Kishës Ortodokse i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.

5. Ky vendim hyn në fuqi, ditë e aprovimit, nga Kuvendi Komunës dhe shfuqizon vendimin Nr. 127, të datës 01.10.2014.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Palëve dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS * OPŠTINA KOSOVO POLJE
FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE